



Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 64 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë dhe me nenin 8 të Rregullës së KQZ nr. 01/2013 mbi Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datë 04.12.2019, merr këtë:

VENDIM

për largim nga regjistri i partive politike të partisë politike Partia Liberale e Kosovës

- I. Për mos aplikim për certifikim KQZ-ja për të marrë pjesë në tri palë zgjedhje të njëpasnjëshme, partia politike 'Partia Liberale e Kosovës', me akronimin PLK, e regjistruar më 21 gusht 2000 largohet/çregjistrohet nga regjistri i partive politike.
- II. Kryetari dhe organet drejtuese të partisë politike 'Partia Liberale e Kosovës', me akronimin PLK, edhe pas marrjes së vendimit për çregjistrim nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, vazhdojnë të mbesin përgjegjës për të gjitha të obligimet e krijuara gjatë periudhës së të qenurit aktiv.
- III. Obligohet Zyra që ta njoftoj përfaqësuesin e partisë politike "Partia Liberale e Kosovës- PLK", për marrjen e këtij Vendimi dhe që ta largoj të njëjtën nga Regjistri i Partive Politike.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

Arsyetim

Në bazë të Rregullës Zgjedhore 01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, në lidhje me Çregjistrimin e partive politike nga regjistri i partive të regjistruara, në germën c) të nenit 8 theksohet se: 'Me vendimin e KQZ-së, Zyra e fshin nga regjistri i partive politike, nëse: ... c) nuk është certifikuar nga KQZ-ja për të marrë pjesë në tri pale zgjedhje të njëpasnjëshme.' Partia politike, 'Partia Liberale e Kosovës-PLK', nuk rezulton të jetë e certifikuar për të marrë pjesë në të paktën tri palë zgjedhjet e fundit (2014, 2017, 2019), as si parti politike në vete dhe as si pjese e ndonjë koalicioni parazgjedhor, dhe si e tillë kualifikohet për t'u fshirë nga regjistri i partive politike të regjistruara.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Republika e Kosovës
Centralna Izborna Komisija
Prishtinë / Pristina


Valdete Daka, Kryetare

Këshillë juridike: Kryetari i partisë politike, 'Partia Liberale e Kosovës', me akronimin PLK, z. Skënder Gashi, ka të drejtë ankese në Panelin Zgjedhore për Ankesa dhe Parashpresa – PZAP, brenda 24 orëve nga pranimi i këtij vendimi të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për çregjistrim nga regjistri i partive.